



SHOQATA KOMBËTARE E GRUAS PROFESIONISTE, AFARISTE DHE ZEJTARE

Politika “pro biznes” apo “pro shtet”?!

Editorial

Kaluan 4 vite te qeverisjes së majtë dhe tashmë erdhi koha për të bërë një bilanc se cila politikë ka qenë më e sukseshme për zhvillimin e ekonomiko- social të vendit: politika e të djathtës 2005-2013 “pro biznes” apo politika e të majtës 2013-2017 “Pro shtet”!

Sipas EU business monitor 2013 të rinjtë shqiptar renditen në vendin e parë në Evropë në lidhje me “shpirtin sipërmarrës”, marrjen përsipër të riskut, dëshirën për të filluar një biznes, por kjo fryme ka ardhur duke u reduktuar në vitet në vijim.

A u ulën më shumë krimet?

Krimet vazhdojnë të jenë të larta në vend, duke mos u ndikuar nga rritja e madhe e efektivëve të policisë gjatë këtyre 4 viteve të fundit. Aksidentet automo-

bilistike vazhdojnë të jenë të larta pa u ndikuar shumë nga rritja e numrit të efektivëve të policisë rrugore apo nga vendosja e sinjalistikës rrugore.

A u përmirësua klima e të bërit biznes në Shqipëri?

U përmirësua ndjeshëm shlyerja e detyrimeve të familjarëve dhe bizneseve në pagimin e energjisë së konsumuar. Por pati pasoja në aspektin social kryesisht për familjet e varfëra të cilët nuk kanë të ardhura nuk kanë mundësi të paguajnë energjinë elektrike dhe në mjaft raste u është ndërprerë energjia apo janë futur edhe në burg për lidhje të parregullta të energjisë elektrike.

(vijon faqe 3)

Buletin Informativ

Qershor 2017

NË KËTË NUMËR

Panairi ndërkombëtar “China Fair 2017”

SHGPAZ merr pjesë në panair me një grup gra sipërmarrëse . Faqe 4



Unioni i presidenteve të sipërmarrjes femërore të Ballkanit

Në Novi Sad mbahet takimi vjetor i presidenteve të sipërmarrjes femërore të vendeve të Ballkanit.

Faqe 5



Forumi ekonomik i Bashkisë Tiranë

8 qershor 2017 u mbajt Forumi Ekonomik i Bashkisë Tiranë.

Nje mënyrë e re takimi: Këshilli ekonomik i bashkisë Tiranë u mbajt në mjediset e pazarit të ri, me tematikë financimi, politikat shtetërore në mbështetje të grupeve të interesit, si edhe të grave në biznes.

Dhënia e granteve po gjen zbatim për produktet artizanale si suvenire sa më cilësore për turistin vendas dhe të huaj. Këto

aktivitete janë në fazën përgatitore dhe po monitorohet edhe nga SHGPAZ.



Partneritet me bashkinë e Pukës, për sipërmarrjen femërore dhe artizanatin

28 qershor 2017. Nga Flutura Xhabija



Puka, është një nga zonat më të varfra të Shqipërisë; gratë nuk kanë asnjë shans a zgjedhje, por...nxitja, promovimi dhe kualifikimi i tyre është emergjencë. Mundësitë për t'i integruar janë të pakta; mbetet artizanati dhe mjeshtritë në shërbime lokale dhe turistike; gjetje tregjesh

shitjeje, mbledhje bimësh medicinale; b&b etj.

Një pjesë e vogël shumë të atyre artizaneve, tregtareve, afaristeve që mbajnë familjet, por që robtohen, pa pasur asnjë informacion, impakt, bashkëpunim me simotrat të regjionit ku jetojnë, të regjioneve të tjera të Shqipërisë, as të Shkodrës që e kanë një orë larg, se për Tiranën, as bëhet fjalë. 😞😞 Sa keq, ndjen dhimbje që nuk i ndihmon dot sepse janë ndryshkur zinxhirët social-ekonomik dhe kështu plaken duke ëndërruar hënën e përparimit... megjithatë une shkoj e flas, kontribuoj dhe i

suportoj sa të di e sa mundem. Puka e Migjenit, gati 80 vite më parë, është ende e mjerë, po boshatiset nga të rinjtë dhe femijet...ishalla shpëtohet tash e mbrapa 🙄😞🙏

Për të mbyllur muajin e nxehtë natyralisht dhe politikisht, presidentja e SHGPAZ, organizoi tre ditë takime me degët e shoqatës në Veri të Shqipërisë: Pukë, Fushë Arrëz dhe Shkodër; bisedat, përvojat, mendimet dhe përpjekjet për të ndryshuar sa më shpejt mentalitetin, situatën social-ekonomike të grave, ishin shumë miqësore, të sinqerta dhe me pjekuri, aq sa kryeqytetit mëndjemadh e parashumë, as i shkon ndërmend e as i shijon: nuk ka shanse 😊😊; së pari inteligjencia e grave të këtyre zonave është e dukshme, bukuria fizike e admirueshme, (*vijon faqe 3*)

“Pro biznes” apo “pro shtet”?!

(nga faqe 1)

Gjithashtu ndryshuan tarifat e energjisë elektrike ku u hoq fashoja prej 300 kwh me tarifa më të reduktuara që kryesisht ndihmonte shtresën e popullatës me të ardhura të ulta.

A patëm më shumë investime të huaja?

Investimet më të mëdha gjatë këtij 4 vjeçari të fundit ishin ato të TAP-it kontrata e të cilit ishte firmosur para vitit 2013, pra me qeverinë e djathtë, si edhe të Statkraft hidrocentrali Devollit që përsëri kontrata ishte firmosur që nga koha e qeverisë paraardhëse. Ashtu si edhe investimet e mëdha që po kryen në bulevardin e ri të Tiranës mbajnë firmën e qeverisë së mëparshme. Nuk mund të përmëndim asnjë investim të madh të inicuar e implementuar nga qeveria e majtë. Asnjë park industrial apo zonë ekonomike apo teknologjike nuk arriti të krijohet as në periudhën 2005-2013 dhe as në periudhën 2013-2017. Edhe pse policia është më aktive përsëri mungonjë investorët e rinj të huaj sepse mungonjë incentivat dhe politikat lehtësuese të taksave për të tërhequr investitorë të huaj, sikundër kanë bërë vendet e rajonit e sidomos Maqedonia.

A u hapën më shumë vende pune?

Mund të themi se vetëm u formalizuan punonjësit e



mëparshëm, por rritja e vendeve të reja të punës ishte e ulët dhe nuk mundi të plotësonte kërkesat gjithmonë në rritje të të rinjve të vendit të cilët gjithmonë e më shumë kërkojnë të largohen nga Shqipëria për të gjetur një punë e për një jetë më të mirë që nuk po ja ofrojnë politikat ekonomike të vendit të tyre.

Krijimi i sipërmarrjeve të reja

Gjatë tre viteve të fundit është rritur me rreth 40% numri i sipërmarrjeve të reja të krijuara, por në realitet këta janë vetëm individë ambulantë të vetë-punësuar si dhe fermerë të cilët ka qenë të përjashtuar më parë nga regjistrimi sepse xhiroja vjetore e tyre ka qenë në nivele minimale. Gjithashtu janë regjistruar edhe sipërmarrje që punonin në informalitet. Nuk konstatohet krijimi i kompanive të mesme apo të mëdha.

Korrupsioni sipas departamentit të Shtetit Amerikan, por edhe sipas raporteve të tjera mbetet ende lartë.

Biznesi kërkon një klimë të të bërit biznes sa më miqësor, por natyrisht në një treg me rregulla të mirëpërcaktuara dhe të zbatuara dhe me një konkurrencë të ndershme!

Takim me degët e SHGPAZ në veri

(nga faqe 2)

punët e tyre të paimagjinueshme dhe guximi qytetar i lakmueshëm; pastërtia trupore dhe e mjedisit ku punojnë të lenë pa mend dhe butësia e shpirtit të tyre të bënë të ndjehesh gati-gati fajtores, që nuk i ndihmon sa e si duhet 😊☺; në bizneset që takon, në kafenetë ku shijon natyrën qiellore malore, në tavolinat e drurit ku han drekat e darkat me kuzhinë vendase bio, ti mahnitesh sa të bukur e bëjnë jetën familjare e qytetare keto gra të vullnetshme e shpresëshumë; ato punojnë aq shumë për të nxjerrë të ardhura për shtëpitë e veta dhe të kontribuojnë edhe për qytetin.



Në qendrën komunitare, ne Puke, u takuam me 10 artizane dhe dy bizneswomen; pastaj një takim me kryetarin e bashkisë, një tjetër në hotel turizmin dhe një darkë & natë në hanin/ bujtinën e Përparim Laçit. Të thithësh fonde dhe të bësh produktin që gjeneron punësim, shërbim dhe inovacion nuk është mëkat, por të perlash fonde miliona-eroshe për investime kot, të ngrira ose pa asnjë destinacion kjo është shkatërrim.

Panairi ndërkombëtar “China Fair 2017”

Më 3-4 qershor 2017, në Stamboll të Turqisë u mbajt Panairi Ndërkombëtar China Fair 2017.



Një delegacion me sipërmarrëse të SHGPAZ u përfaqësuan në këtë panair. Panairi ishte i organizuar mjaft mirë, gjallëri e madhe dhe një oportunitet për sipërmarrëset shqiptare.

BE-ja mbështet sipërmarrës të rinj shqiptarë

Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë njoftoi 5 fituesit për sipërmarrës të rinj start up në kuadër të nismës “Start up Albania 2017”. Ky projekt u realizua nëpërmjet rrjetit të informacionit të BE-së në bashkëpunim me Ministrinë e Inovacionit e Administratës Publike dhe AIDA.

Ndërsa jepte çmimet ambasadorja e Delegacionit të BE-së znj. Romana Vlahutin theksoi se të tilla iniciativa inkurajojnë të rinjtë shqiptarë dhe u ofrojnë mundësi për të konkuruar në tregun evropian.

Start up Albania 2017 u lancua më 1 mars 2017, ku aplikuan 77 të rinjë në fushat teknologjisë së informacionit, biznesit social dhe bujqesisë. Projekti kishte për qëllim të forconte klimën e biznesit drejt inovacionit dhe teknologjisë si element kyç për zhvillimin e biznesit me focus të veçantë të rinjtë. Sipas Vlahutin start ups akoma kanë vështirësi në gjetjen e një klime të favorshme në Shqipëri, prandaj BE-ja do të mbështeti eco-

sistemet innovative nëpërmjet krijimit të inkubatorëve të biznesit, përmirësimit të aksesit në financë dhe mbështetjes për strat up innovative.

BE-ja mbështet sektorin e Konkureshmërisë dhe Inovacionit për periudhën 2014-2020 me rreth 50 milion Euro, nga të cilat 6.6 milion Euro janë dedikuar për inovacionin.



Takimi vjetor i presidenteve të sipërmarrjes femërore të Ballkanit

Më 16 qershor 2017, në Novi Sad u mbajt takimi vjetor i presidenteve të sipërmarrjes femërore të vendeve të Ballkanit. Shqipëria përfaqësohej nga presidentja e SHGPAZ znj. Flutura Xhabija, e cila shoqërohej edhe nga një grup gra sipërmarrëse.



Dy lektorë të hatashëm prezantuan: 1. "nomadet dixhitale i kthyer nga Londra, vendosi të hap biznes dixhital në fshatin e tij.

Për këtë ai ftonte të rinjtë të mos rrinë kot, të mos presin nga mami e babi; telefoni dhe mjetet e reja dixhitale të japin mundësi të krijosh çdo ditë; mos prisni zyrë fizike, krijoni zyrë dixhitale; merrni pjesë në fshatin global, me krijimet tuaja (ky është biznes shumë fitimprures); kjo ju mundëson të mos jeni të izoluar dhe të ndjeheni pozitiv; kështu rivalizoni: rrugën, lagjen,

qytetin, fshatin tuaj ku sigurisht gjënden vlera të pazbuluara, por jepini vetes pak refleksim. Mark Tueni thote "edhe pse jeni të rrethuar me njerëz, është koha për pushim dhe kështu reflektoni"

2. Lektorja më e çuditshme ishte zonja Dropuliç; inteligjente, e gjallë, 20 vjet në biznesin e saj "qendra virtuale e zhvillimit"; e paparë, ajo shtoi: në këto 10 vitet e fundit jemi zhvilluar më shumë se 100 vitet që kaluan. Brezi 1965-1980, është brezi më i lumtur, por brezi i ri nuk do mund të jetojë pa internet, telefonat do të jenë më inteligjente se njerëzit, kontaktet fizike do të minimizohen. Deri në 2025 do të jetojnë ato biznese që janë të përgatitur për "erën e re". 5 vendet më të mëdha po përgatiten, por go përqind e vendimeve botërore merren nga SHBA, sepse kanë kapacitete të përgatitura edhe për 100 vite,



Europa Juglindore dhe Ballkanike ka krizë demografike: kush do të jenë klientët e ardhshëm të tyre?!

"Panair i artizanatit në Novi Sad

Më datat 14-17 qershor 2017 një grup artizanesh anëtare të SHGPAZ morrë pjesë në panair.



Shoqata e grave sipërmarrëse novisadase, e re si OJF, por e mirëorganizuar; fillon me një kafe mikpritëse, një kuartet femëror violinash, muzikë nga List dhe pastaj një panair profuktesh bio; konferenca fillon me prezantime lokale dhe rajonale, por pastaj ndahet në panele profesionale: si të ushqehemi, si të përdorim mjekësinë tradicionale, si të kemi masën e duhur edhe në biznes, sepse dëshira për t'u bërë shpejt i madh, rrezikon edhe atë që ke pasur në fillim; po kështu masa duhet edhe për të ruajtur familjen, fëmijët dhe njerëzit e tjerë të saj shumë të afërt....etj. Në panair prezantohej një produkt me kanabis, për dhimbjet reumatizmale në gjunjë; po kështu shallat origjinale mënda-fshi me çmim 20 euro; një tjetër universitet privat, që merret me sipërmarrjen, jo vetëm femërore; dy gra prodhojnë në mënyrë shtëpiake llokume të vogla, me shije molle, arre, manafërre etj, por një paketim të mrekullueshëm. Gjithashtu Laureta nga Lezha në një stend të veçantë prezantoi sapunet bio te formave te ndryshme, me cilësi të mirë.

Tatimet “shtrëngojnë duart” me biznesin. Ndryshon qasja tatime-sipërmarrje

nga **Violeta Shqalsi**

Prej vitesh klima mes biznesit dhe administratës tatimore ka qënë e acaruar. Arroganca e tatimorëve, por dhe niveli i lartë i informalitetit tek sipërmarrja bëri që në shumë raste të mos funksiononte marrëdhënia mes tyre. Gjatë viteve të fundit kanë qënë të shumta çështjet që janë apeluar nga biznesi, ndërkohë që kontrollet e shumta ndikonin negativisht në performancën e tyre. Por ndryshimi i konceptimit të kësaj marrëdhënie, ku tatimet po i konsiderojnë partner bizneset, duket se po jep rezultate pozitive në të dy krahët. Kështu ulja e “dozës” së kontrolleve dhe lejimi i bizneseve të vetëkorrigjohen, ka ndryshuar qasjen e biznesit ndaj tatimeve dhe anasjelltas. Kështu pas nisjes dy vjet më parë të luftës ndaj informalitetit, aksion i cili nisi “me dorë të hekurt”, duket se tashmë është zbutur dhe më tepër po lejohen sipërmarrjet të vetëkorrigjohen, sesa të jetë objekt i penalteteve. Ndërkohë që ndërmarrja e nismës së “amnistisë”, ku pritet të falen mjaft detyrime të biznesit, duket se do t’i japë një “frymëmarrje” sipërmarrjes. Por këto rezultate mbi kto nisma, por edhe me shifra dhe fakte, na jep në një interviste Drejtore e Përgjithshme e Tatimeve, Vasilika Vjero.

Pyetje 1-Tashmë prej muajsh jeni në krye të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, dhe ka ndryshuar qasja e tatimorëve ndaj bizneseve. Cila është qasja dhe ku është fokusuar kjo marrëdhënie e re? Sa kanë ndikuar ndryshimet në procedurat tatimore dhe ku kanë patur impaktin më të madh dhe më të vogël, në cilët sektorë?

Fokusi i punës dhe përpjekjeve të administratës tatimore, gjatë muajve të fundit ka qënë dhe është përmirësimi i marrëdhënieve me biznesin pa cënuar dhe dëmtuar për asnjë moment kërkesën për zbatimin në mënyre korrekte të legjislacionit fiskal. Lidhur me këtë gjatë muajve të fundit e në vijim administrata tatimore ka shënuar disa arritje të rëndësishme:

- Filloi zbatimin në nivel qendror dhe rajonal i strukturës së re organizative, e cila u përgatit me shumë kujdes me asistencën e FMN-së për t’ju përgjigjur dhe përshtatur zhvillimeve të fundit të administratës tatimore dhe sidomos implementimit të sistemit të ri informatik të tatimeve.
- Përgatiti dhe miratoi planin e ri strategjik për vitet 2017-2021 me synime të qarta strategjike, në qendër të të cilëve është përmirësimi dhe rritja e nivelit të



përmishjes vullnetare të detyrimeve tatimore.

- DPT prezantoi faqen e re të Web-it të saj me synimin për ta bërë atë më miqësore me tatimpaguesit dhe të orientuar plotësisht drejt këtyre të fundit. Ku pjesë e kësaj faqeje informuese është dhe shërbimi “chat” në kohë reale. Nëpërmjet këtij shërbimi tatimpaguesit/ qytetarët kanë mundësi të marrin informacione të shkurtëra dhe të dedikuara për çështje që ata ngrejne lidhur me administratën tatimore.

- Është krijuar Qendra e Thirrjeve e cila ka filluar të funksionojë që prej fundit të vitit të kaluar dhe do të jetë në shërbim të nevojave të tatimpaguesve. Ajo synon t’u vijë në ndihmë kategorive të veçanta të tatimpaguesve duke i kujtuar ato në menyrë të vazhdueshme për afatet e deklarimit dhe pagesës, për menyrën e deklarimit, për menyrën e vetëkorrigjimit të situatës së tyre, për borxhet e reja të papaguara, etj. E reja kryesore qëndron në faktin se tashmë duke filluar nga muaji Shkurt do t’ju krijohet mundësia tatimpaguesve të komunikojnë lehtësisht me administratën tatimore.

FAKTE

26.8%

Biznese aktive të drejtuara/pronare gra, për vitin 2016 në Shqipëri rezultojnë 26.8% me një rënie me 4.5 pikë % në krahasim me vitin 2015 ku përbënin 31.3%.



3.2%

Rritja e kredisë për vitin 2016 rezulton me një rritje modeste me vetëm 3.2% krahasuar me një vit më parë.



Takim me artizanet e Korçës



Në

Korçe, më 18 qershor 2017, u organizua një panair artizanal nga një grup i SHGPAZ; por biseda me to, këshillimet dhe mundësitë për të përfituar mjaft nga mekanizmat shtetërore, nga politika dhe donatorët; shfrytëzimi i situatave të zgjedhjeve dhe prezantimi i nevojave të tyre të dedikuara për gratë është proces emergjent! Angazhim dhe monitorim! 🍋



Gruaja dhe shëndeti

Kanceri i lëkurës

Materiale të përpunuara nga **Arlinda Demeti**

Kanceri i lëkurës është mjaft i përhapur në Shqipëri dhe renditet i dyti pas kancerit të zorrës së trashë. Melanoma është një nga llojet më të rrezikshme të kancerit të lëkurës duke shkaktuar rreth 75% të vdekjeve nga të gjitha format e kancerit të lëkurës dhe duke u konsideruar kështu si një problem i madh social. Ajo zhvillohet në qelizat prej të cilave prodhohet melanina-pigmenti që përcakton ngjyrën e lëkurës sonë. Gratë janë më të rrezikuara nga melanoma me një shkallë rreziku në 1 me 20, ndërsa shkalla e rrezikut për meshkujt është më e ulët në 1 me 50.

Shkaku i melanomave nuk është i qartë, por ekspozimi ndaj rrezeve ultraviole të diellit (UV). Dielli prodhon rrezatimin UV, por edhe aparaturat estetike, siç janë solaret janë burim i prodhimit të tyre, prandaj përdorimi i solarëve rrisin shumë riskun e zhvillimit të këtij lloji kanceri. Gjithashtu, në faktorët riskues ka edhe një



komponent gjenetik si histori familjare me melanoma.

Pjesa më e madhe e vendeve mesdhetare kanë nivele të larta të rrezeve UV gjatë gjithë vitit. Ky rrezatim nuk mund të shihet ose të ndihet por mund të shkaktojë:

- Djegje nga dielli;
- Plakje të parakohshme të lëkurës;
- Dëmtim të qelizave të lëkurës, që çojnë në krijimin e kancerit të lëkurës.

Specialistët rekomandojnë të kihet kujdes nga djegia e diellit e sidomos personat më të rrezikuar nga ky kancer janë ata me lëkurë të bardhë. Gjithashtu ata tregojnë se rastet e personave të prekur nga kjo sëmundje po vijnë gjithnjë e në rritje dhe mjekët po vënë alarmin se kanceri i lëkurës po prek edhe të rinjtë.

Askush nuk është i mbrojtur nga melanoma, por mjekët thonë se ajo mund të parandalohet duke filluar me një vetëkontroll.

Diagnostikimi i hershëm i melanomës, pra identifikimi i saj në formën sipërfaqësore mund të ulë si sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë nga kjo patologji. Mjekët këshillojnë njerëzit të vërejnë ndryshimet në porët e lëkurës që mund të ndryshojnë në nishane, në madhësi apo formë. Më tej mjekët rekomandojnë shmangien e solarëve për nxirje



artificiale të lëkurës, pasi ato i konsiderojnë si makineri të kancerit.

Kurimi i këtij kanceri varet nga lloji dhe nëse ai është përhapur apo jo.

Etapat diagnostike:

Cilat janë shenjat diagnostikuese të Melanomës:

Melanomat me përhapje sipërfaqësore janë zakonisht:

- Më të mëdha në sipërfaqe se sa nishanet normale dhe rriten në madhësi në mënyrë progresive me kalimin e kohës. Pjesa më e madhe (por jo të gjitha) kur diagnostikohen janë 7 mm apo më shumë në diametër.
- Të çrregullta në ngjyrë zakonisht tre apo më shumë ngjyra (kafe, e zezë, blu në të zezë).
- Të çrregullta në formë. Janë asimetrike me kufinj gjeografikë.

Melanomat nodulare zakonisht kanë ngjyrë të çrregullt, por ato mund të jenë më shumë uniforme në ngjyrë në krahasim me melanomat me përhapje sipërfaqësore. Këto tumore mund të janë zakonisht me ngjyrë të zezë apo të kuqe dhe mund të ulçerohen. **Kujdes nga rrezet e diellit gjatë kësaj vere tepër të nxehtë!**

Takim SHGPAZ me Akademinë e Biznesit

Me 8 qershor 2017, Presidentja e SHGPAZ, znj. Flutura Xhabija u takua me stafin e Universitetit Akademia e Biznesit me të cilët ka një bashkëpunim në implementimin e projekteve të ndryshme për mbështetjen e sipërmafrres femërore.



Festa kombëtare e Sllovenisë

Ambasdore mund të jetë secila prej nesh, nëse do, di, kërkon dhe ...çmon më shumë atdheun.

6 qershor 2017, me rastin e festës kombëtare të Sllovenisë ambasadorja Lea Stançiç dha një pritje në seline e saj në Tiranë.


Sllovenia diti të integrohet me dinjitet i pari në BE, edhe pse më i vogël se Shqipëria në sipërfaqe dhe popullsi: por ka pasur Burra dhe Gra, me kualitet! Flm shumë!



Takim në degën e SHGPAZ Pogradec



Takim me artizanet e zones dhe sipërmarrëset e reja. Shoqata modeste lokale, por punojne me publikun ne mjedise te thjeshta, por te dobishme per qytetaret në problemet specifike qe asnjehere shteti&pushteti, nuk mund t'i zgjidhe e as t'i trajtoje! Flm



shoqata e grave intelektuale ne Pogradec, dhe themelueses se saj, Shpresa Bllaceri



Bashkë mundemi

Duam të flasim për punën e palodhur dhe modeste të Arbër Hajdarit dhe grupit të tij.

Këta janë politikanë e jo ata/ato që zhvatën këtë vend për 27 vjet!

Të lumtë Arber, ty e grupin tënd! Shqiperia nuk ka qenë e nuk duhet kurrë të jetë e varfër!

Tek shtëpia e re e nënë Mites në Durrës më 18 qershor 2017.



Buletin Informativ

Qershor 2017



Rr.Mujo Ulqinaku,
Pall.Kristian Konstruktion,
kati 1, ap.9 Tirana-Albania
phone/fax:00355 4 2235726
mob.0682763344, 0692572423
info.shgpaz@yahoo.com

Pergatiti
Msc. Flutura XHABIJA &
Redaksia